**VENDIM**
**Nr. 219, datë 13.4.2023**

# PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I SHESHIT PËRPARA DEGËS SË THESARIT TIRANË, RRUGA 'MUSTAFA LLESHI'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i sheshit përpara Degës së Thesarit Tiranë, rruga 'Mustafa Lleshi'".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall", me një vlerë të përgjithshme prej 54 608 531.59 (pesëdhjetë e katër milionë e gjashtëqind e tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e një pikë pesëdhjetë e nëntë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 54 608 531.59 (pesëdhjetë e katër milionë e gjashtëqind e tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e një pikë pesëdhjetë e nëntë) lekësh, përballohet nga Bashkia Tiranë.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Tiranë.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Tiranë.
8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

# LISTA EMËRORE PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I SHESHIT PËRPARA DEGËS SË THESARIT TIRANË, RRUGA 'MUSTAFA LLESHI'"

| NR. | PRONËSIA | | | TË DHËNA KADASTRALE | | | | | | | | | TË DHËNAT E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN | | | | | | | | | | SHËNIME | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | | TRUALL | | | NDËRTESË BANIMI | | | NDËRTESË SOCIAL EKONOMIKE | | | VLERA E SHPRONËSIMIT | | |
| | EMËR | ATËSI | MBIEMËR | QYTETI | ZK | NR. I PASURISË | LLOJI I PASURISË | SIP. TOTALE (m²) | TRUALL (m²) | NDËRTESË (m²) | VOL | FAQE | SIPËRFAQJA (m²) | ÇMIMI (lek/m²) | VLERA (lekë) | SIPËRFAQJA (m²) | ÇMIMI (lek/m²) | VLERA (lekë) | SIPËRFAQJA (m²) | ÇMIMI (lek/m²) | VLERA (lek) | VLERA TOTALE (LEKE) | (Kufizime hipotekare barre mbi pasurinë etj.) | Shënime të tjera |
| **1** | Haxhi | Rushit | Muçaj | Tiranë | 8160 | 3/76 | Truall | 92.5 | 92.5 | 37.30 | 17 | 154 | 92.5 | 66,969 | 6,194,632.50 | 37.30 | 96,485.19 | 3,598,897.59 | 37.30 | 20,091.14 | 749,399.48 | **10,542,929.57** | Konfirmuar nga ASHK-ja D - Pasuria bllokohet në favor të "Banka e Parë e Investimeve Albania" sh.a. për shumën 2.725.000 lekë | Shënim S.Sh.: Në përgjigje të aplikimit nr. 85995, datë 9.12.2022, objekti i pozicionuar mbi pasurinë nr. 3/76, Zk 8160 është konfirmuar si godinë e kombinuar 1 kat + 1 kat nën tokë, ku kati përdhes është me funksion banim, ndërsa kati nëntokë është me funksion social-ekonomik. |
| **2** | Shaban | | Gega | Tiranë | 8160 | 3/460 | Truall | 19.00 | 19.00 | 0.00 | 12 | 175 | 19.00 | 66,969 | 1,272,411.00 | | | - | 0.00 | | - | **1,272,411.00** | Konfirmuar nga ASHK-ja | |
| **3** | Zoica | Jorgji | Frasheri | Tiranë | 8160 | 3/73 | Truall | 172.00 | 172.00 | 0.00 | 15 | 104 | 158.00 | 66,969 | 10,581,102.00 | | | - | 0.00 | | - | **10,581,102.00** | Konfirmuar nga ASHK-ja | |
| **4** | Arjan | Zef | Dodaj | Tiranë | 8160 | 3/653 | Truall | 15.00 | 15.00 | 0.00 | 18 | 112 | 15.00 | 66,969 | 1,004,535.00 | | | - | 0.00 | | - | **1,004,535.00** | Konfirmuar nga ASHK-ja | |
| **5** | Arjan | Zef | Dodaj | Tiranë | 8160 | 3/654 | Truall | 18.00 | 18.00 | 10.00 | 18 | 192 | 18.00 | 66,969 | 1,205,442.00 | | | - | 0.00 | | - | **1,205,442.00** | Konfirmuar nga ASHK-ja | Shënim. S.Sh.: Nga verifikimi në terren dhe referuar ASIG-ut, nuk ka ndërtesë ekzistuese, për këtë arsye nuk ndërtesa nuk është pjesë e llogaritjeve. |
| **6** | Vjollca Ylli | | Peci Peci | Tiranë | 8160 | 3/48 | Truall | 30.00 | 30.00 | 0.00 | 12 | 99 | 25.00 | 66,969 | 1,674,225.00 | | | - | 0.00 | | - | **1,674,225.00** | Konfirmuar nga ASHK-ja | |
| **7** | Lirie | Ismail | Bejtja | Tiranë | 8160 | 3/12 | Truall | 146.00 | 146.00 | 0.00 | 13 | 41 | 26.00 | 66,969 | 1,741,194.00 | | | - | 0.00 | | - | **1,741,194.00** | Konfirmuar nga ASHK-ja | |
| **8** | Ferik | Zenel | Gremshi | Tiranë | 8160 | 3/517 | Truall | 17.00 | 17.00 | 0.00 | 13 | 157 | 4.00 | 66,969 | 267,876.00 | | | - | 0.00 | | - | **267,876.00** | Konfirmuar nga ASHK-ja | |
| **9** | Dashnor Albana | Malush Xhavit | Malushi, Ruçi | Tiranë | 8160 | 3/516 | Truall | 78.00 | 78.00 | 57.30 | 13 | 156 | 18.00 | 66,969 | 1,205,442.00 | | | - | 0.00 | | - | **1,205,442.00** | Konfirmuar nga ASHK-ja Seksioni E: Vendim leg. shtesë anësore 1-katëshe. Sip. e katit përdhes = 57.3 m²/soc.-ekonomike. | |
| **10** | Fatbardha | Sefer | Goni | Tiranë | 8160 | 3/506 | Truall | 140.00 | 140.00 | 0.00 | 13 | 98 | 140.00 | 66,969 | 9,375,660.00 | | | - | 0.00 | | - | **9,375,660.00** | Konfirmuar nga ASHK-ja | |
| **11** | Artan Miranda Farije Qerim | | Mata Shima Mata Mata | Tiranë | 8160 | 3/507 | Truall | 30.00 | 30.00 | 0.00 | 13 | 97 | 30.00 | 66,969 | 2,009,070.00 | | | - | 0.00 | | - | **2,009,070.00** | Konfirmuar nga ASHK-ja E - pasuria pa datë lëshimi. certifikate e vlefshme për informacion. | |
| **12** | Hasan Gezim Bujar Ganimet Myzejen | ……. Shaban Shaban Shaban Shaban | Sokoli Sokoli Sokoli Sokoli Kashari Kodra Sokoli Sauku Hyka | Tiranë | 8160 | 3/31 | Truall | 1869.00 | 1869.00 | 0.00 | 24 | 191 | 9.00 | 66,969 | 602,721.00 | | | - | 0.00 | | - | **602,721.00** | Konfirmuar nga ASHK-ja | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shpresa Mustafa Suzana Kujtim Bukurije Deshirë Fatos Ilir | Shaban Shaban | Kita Mihalçka Hyka Hyka | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| **13** | Antoneta Marjana Loreta Jorgjeta Liljana | | Ballamaci Ballamaci Ballamaci Ballamaci Ballamaci, etj | Tiranë | 8160 | 3/402 | Truall | 18.00 | 18.00 | 0.00 | 13 | 154 | 11.00 | 66,969 | 736,659.00 | | | - | 0.00 | | - | **736,659.00** | Konfirmuar nga ASHK-ja | |
| **14** | Besnik | Faik | Meça | Tiranë | 8160 | 3/394 | Truall | 204.00 | 204.00 | 204.00 | 18 | 211 | 185.00 | 66,969 | 12,389,265.00 | | | - | 0.00 | | - | **12,389,265.00** | Konfirmuar nga ASHK-ja Seksioni C - Kontratë dhurimi | Shënim. S. Sh.: Referuar planit të prishjeve dhe të verifikimit nga ASIG-u, nuk ekziston ndërtesë mbi këtë pasuri. |
| | **VLERA E SHPRONËSIMIT** | | | | | | | | | | | | **750.50** | **66,969** | **50,260,234.50** | **37.30** | **96,485.19** | **3,598,897.59** | **37.30** | **20,091.14** | **749,399.48** | **54,608,531.59** | | |